L I G J
Nr.8757, datë 26.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8321, DATË 2.4.1998, "PËR POLICINË E BURGJEVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8321, datë 2.4.1998 "Për Policinë e Burgjeve" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë ndryshohet si vijon: "Policia Burgjeve është strukturë e armatosur në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve."
- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon: "Policia e Burgjeve i kryen detyrat e veta mbështetur në këtë ligj dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e saj."
- Paragrafi i katërt ndryshohet si vijon: "Policia e Burgjeve gëzon të gjitha të drejtat që parashikon ligji nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit"."

Neni 2

Në fund të nenit 3 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Në raste të veçanta, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, veprimtaria e saj mbështetet nga Policia e Shtetit."

Neni 3

Në nenin 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

"5. Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, veprimtaria e të cilit rregullohet me ligj të veçantë."

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- Fjalia e parë ndryshohet si vijon: "Funksionet e punonjësve të Policisë së Burgjeve janë si më poshtë:"
- Shkronja "b" ndryshohet si vijon: "b) Specialist i policisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve."
- Shkronja "d" ndryshohet si vijon: "d) Specialist i policisë në institucion."

Neni 5

Neni 11 ndryshon si vijon:

"Policia e Burgjeve është pjesë përbërëse e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e miratuar nga Kryeministri me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë.

Efektivi i Policisë së Burgjeve përbëhet nga punonjës të rolit bazë, të mesëm, të lartë dhe madhor.

Gradat e tyre janë të njëjta me ato të Policisë së Shtetit.

Gradimi i punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm bëhet nga Drejtori i Policisë së Burgjeve.

Gradat e punonjësve të rolit të lartë jepen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kurse gradat e rolit madhor jepen me dekret të Presidentit të Republikës, në bazë të propozimit të Ministrit të Drejtësisë.

Për gradimin e punonjësve të rolit bazë dhe të mesëm ngrihet pranë Ministrisë së Drejtësisë një komision këshillimor, përbërja dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë."

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala "policëve" zëvendësohet me fjalët "punonjësve të rolit bazë.".
- Paragrafi i fundit ndryshohet si vijon:

"Fituesit e konkursit emërohen punonjës policie të rolit bazë. Titullimi dhe gradimi i tyre bëhet pas mbarimit të kursit përkatës në Shkollën e Policisë së Burgjeve."

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala "oficerëve" zëvendësohet me fjalët "punonjësve të tjerë".
- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Emërimi dhe shkarkimi në funksionet, sipas shkronjave "ç", "d" dhe "dh" të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozimin e Drejtorit të Policisë së Burgjeve, kurse sipas shkronjave "b" dhe "c" të nenit 5 të këtij ligji bëhen nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve."

Neni 8

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin e parë fjala "oficerëve" zëvendësohet me fjalën "punonjësve" dhe fjala "kolonel" me fjalët "punonjës së rolit të lartë ose të barasvlefshëm me të".
- Paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Drejtori i Policisë së Burgjeve emërohet nga Ministri i Drejtësisë me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve."

Neni 9

Neni 16 ndryshohet si vijon:

"Për dhënien ose heqjen e gradave zbatohen të njëjtat kritere që përcaktohen në ligjin nr.8643, datë 20.7.2000 "Për gradat në Policinë e Shtetit."

Neni 10

Neni 18 ndryshohet si vijon:

"Procedimi disiplinor

1. Masat disiplinore jepen nga eprori i drejtpërdrejtë dhe, në çdo rast, i njoftohen punonjësit të policisë. Në çdo rast punonjësi detyrohet të zhdëmtojë dëmin e shkaktuar sipas dispozitave në fuqi.

2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Vendimi për marrjen e masës disiplinore i njoftohet me shkrim të interesuarit dhe shënohet në dosjen vetjake.

3. Dhënia e masave disiplinore dhe shqyrtimi i tyre bëhet sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t'u vënë në dijeni, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur."

Neni 11

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 18/1
Ankimi

1. Në çdo rast punonjësi i Policisë së Burgjeve, ndaj të cilit është marrë masë disiplinore, ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim brenda 10 ditësh tek titullari i institucionit.

2. Kur titullari i institucionit e gjykon të pabazuar dhënien e masës disiplinore, nuk e miraton atë. Në rast të miratimit të masës disiplinore, punonjësi i policisë ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim, brenda 10 ditëve te Komisioni Disiplinor. Titullari i institucionit mund të vendosë pezullimin nga detyra të punonjësit të policisë.

3. Komisioni Disiplinor, kur e gjen të bazuar, vendos lënien në fuqi të masës disiplinore, ose i propozon titullarit të institucionit për ta rishikuar masën e dhënë.

4. Vendimi i Komisionit Disiplinor për lënien në fuqi të masës disiplinore është i formës së prerë, me përjashtim të masave disiplinore të parashikuara në pikat 3, 4 dhe 5 të nenit 17 të këtij ligji, që hyjnë në fuqi me miratim të organit përkatës për emërimin ose dhënien e gradës përkatëse. Miratimi jepet brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit nga Komisioni Disiplinor.

5. Për masat disiplinore të ankimuara, afatet e shuarjes fillojnë nga data kur vendimi i titullarit ka marrë formë të prerë.

6. Përbërja dhe funksionimi i Komisionit Disiplinor përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 12

Pas nenit 18/1 shtohet neni 18/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/2
Heqja dhe shuarja e masës disiplinore

1. Gjatë periudhës në të cilën ndaj punonjësit është marrë masë disiplinore, ndërpritet ecja e afateve që lidhen me fitimin e të drejtave të parashikuara për punonjësin e Policisë së Burgjeve, duke përjashtuar vjetërsinë në shërbim.

2. Në raste të veçanta, kur i ndëshkuari kryen akte përkushtimi në detyrë, heqja e masës disiplinore mund të bëhet nga titullari para afatit.

3. Masat disiplinore, me përjashtim të pikës 6 të nenit 17 të këtij ligji, mund të shlyhen nëse brenda një viti nga data e dhënies së tyre ndaj punonjësit të policisë nuk është marrë masë tjetër disiplinore. Masat disiplinore të shlyera hiqen nga dosja vetjake.”

Neni 13

Pas nenit 18/2 shtohet neni 18/3 me këtë përmbajtje:

“Neni 18/3
Ankimi në gjykatë

Kundër vendimit të formës së prerë për dhënien e masave disiplinore, të parashikuara në nenin 17 të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 328 të Kodit të Procedurës Civile.”

Neni 14

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“Marrëdhëniet në punë për punonjësit e tjerë të administratës së Policisë së Burgjeve rregullohen në përputhje me Kodin e Punës.”

Neni 15

Në të gjitha dispozitat e ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 fjalët “Policia e Rendit” zëvendësohen me fjalët “Policia e Shtetit”.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2957, datë 6.4.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.